



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:905310
Datë: 17.08.2021
Numri i dokumentit: 02091998

Ac.nr.2835/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit D.K. nga fshati ..., të cilin me autorizim e përfaqëson L.B. nga Prishtina, kundër të paditurve L.V. dhe D.V., që të dy nga fshati ... për shkak të kompensimit të dëmit në shumë prej 8,350.00 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurve të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.319/2014, i datës 17.04.2018, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 04.08.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditurve L.V. dhe D.V., që të dy nga fshati ..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.319/2014, i datës 17.04.2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.319/2014, i datës 17.04.2018, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit D.K. nga fshati ... si e BAZUAR, OBLIGOHEN të paditurit L.V. dhe D.V., qe te dy nga fshati ..., qe ne mënyrë solidare, paditësit të ia paguajnë, në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar me dt. 25.08.2011, ne fshatin ... nga këputja e kolovajzës, shumat si vijon: Dëmin jo material a) në emër të dhimbjeve fizike- trupore shumë prej 900,00.-€, b) në emër te frikës së përjetuar shumë prej 700,00.-€ Për Dëmin material; e) në emër të ndihmës dhe kujdesit te personit te trete shumen prej 112,00.-€, f) në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 112,00.-€, të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dt. 17.04.2018, e deri tek pagesa

definitive. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur: Në pjesën tjetër kërkesëpadia, më tepër se shumat e aprovuara, si në al, I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe kërkesëpadia për kompensimin e shpenzimet për shërim klimatik fizio-terapeutik në shumë prej 250.00.-€ REFUZOHEN si të pa bazuara. Në pikën III ka vendosur që: OBLIGOHEN të paditurit që paditësit t'ia paguaj shumën prej 164,00.-€, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, si dhe shumat nga al. I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi të paditurit në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj apo që aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim për rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurve është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit së tij, me datë 10.06.2014, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, , me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.319/2014, i datës 17.04.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Nga këto prova të administruara, si aktgjykimi penal dhe mendimi i dhënë nga ekspertët gjyqësor nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, gjykata ka ardhur deri tek përfundimi se paditësi në kohën dhe vendin si në pjesën e parë të arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka pësuar lëndime trupore, me lëshimet ekskluzive të të paditurve, të cilët si persona përgjegjës — zotërues të këtyre lojërave, nuk i kanë mirëmbajtur në pikëpamje teknike në gjendje të rregullt kolovajzën (lojërat e fëmijëve), ashtu që për shkak të veprimtimit të forcës mekanike është ardhur tek thyerja e boshtit mbajtës të kësaj kolovajze dhe si pasojë e thyerjes së boshtit mbajtës, paditësi i cili ka qenë duke u sjellë, ka ra me karrige në tokë dhe ka pësuar lëndime trupore, e mbi këtë baze konform nenit 154 173 nenit 174 të LMD-së, të paditurit si zotërues dhe persona që merren me veprimtari të rrezikshme, janë përgjegjës për shpërblimin e demit paditësit, për të gjitha format e tij.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike për paditësin ka caktuar shumën prej 900,00-€, duke pasur parasysh mendimin e ekspertëve gjyqësor, se paditësi ka pasur dhimbje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej një dite kohe pas kohe gjerë në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, dhimbje të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur edhe për 14 dite, dhimbje të intensitetit të ulët sipas të dhënave nga ekzaminimi i paditësit ka pasur edhe në ditën e dhënies së mendimit nga ekspertet gjyqësorë. Në emër të frikës së përjetuar paditësit i është caktuar shuma prej 700,00 euro, duke pasur parasysh mendimin e ekspertit gjyqësor, se paditësi ka përjetuar frikë primare në formë të frikës nga kërcënimin i drejtpërdrejtë për integritetin e tij fizik e cila ka zgjatur për disa minuta, frike sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar për 24 ore, frikë

sekondare të një intensitetit mesatar ka pasur për 3-4 muaj, e cila është manifestuar me frikë nga invaliditeti i përhershëm. Në emër të ndihmës së personit të tretë, paditësit i është caktuar shuma prej 112,00.-€, duke pasur parasysh mendimin e ekspertëve gjyqësor se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 16 ditësh, dhe atë në ndihmë për plotësimin e nevojave personale, e duke llogaritur për çdo ditë të nevojës për ndihmë të personit të tretë nga 7,00. euro. Ne emër të ushqimit të përforcuar paditësit i është caktuar shuma prej 112,00.-euro, e duke pasur parasysh mendimin e ekspertëve gjyqësorë, se ushqimi i përforcuar për paditësin ka qenë i nevojshëm për 16 ditë, si ushqim i pasur me vitamina, minerale, proteina, duke llogaritur se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar më të shtrenjtë se ushqimi i rëndomtë ku për një dite i është llogaritur te nevojës se ushqimit të përforcuar. Lartësinë e dëmit të pësuar jo material, paditësit gjykata ia ka caktuar, konform nenit 190,195 dhe nenit 200 të LMD-së dhe duke u mbështetur në konstatimin dhe mendimin e ekspertëve gjyqësor, përkitazi me natyrën dhe shkallën e lëndimeve të pësuar, intensitetin dhe kohëzgjatjen, mandej duke pasur parasysh moshën e paditësit, si dhe praktiken gjyqësore të gjykatave në Republikën e Kosovës, të cilat për lëndime të ngjashme ua caktojnë shumat e dëmshpërblimit, duke konsideruar se shumat e aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion ekuivalent me natyrën dhe shkallën e lëndimeve të paditësit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurve se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, duke vendosur në kundërshtim me nenin 67 të LPK-së, pasi që gjyqtari dhe paditësi janë fqinjë dhe për këtë nuk është dashur që të vendosë gjyqtari që e ka udhëhequr procedurën. Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, për faktin se të paditurit në asnjë moment gjatë procedurës nuk e kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të çështjes nëse vetëm kanë pasur njohuri se gjyqtari dhe paditësi janë fqinjë. Edhe pse të paditurit me mjetin e goditjes kanë të drejtë që të kundërshtoj marrjen pjesë të gjyqtarit, të njëjtit me asnjë provë nuk e kanë dëshmuar se ekzistojnë rrethana që e vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit, sepse arsyeja vetëm pse janë fqinjë nuk do të thotë se gjyqtari do të jetë i paanshëm sepse nuk dihet se çfarë raporte fqinjësore kanë të njëjtit.

Nuk qëndron pretendimi se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësit lëndimet i janë shkaktuar për shkakun që nuk janë mirëmbajtur si duhet lojërat e fëmijëve, e si pasojë e kësaj ka ardhur edhe deri te shkëputja nga boshti i vetë duke u rrotulluar në ajër e kështu i gjithë rrethi me karriget e saj kanë rënë në tokë, e me këtë paditësi ka pësuar lëndime trupore dhe atë ndrydhje të shpinës, ndrydhje në pjesën e gjoksit dhe të belit, lëndime këto të cilat janë karakterizuar si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, e po ashtu të paditurit janë shpallur edhe fajtor me aktgjykim penal për shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 154, 173 dhe 174 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 1 tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji.”*, neni 173 përcakton se: *“Dëmi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari me përjashtim në qoftë se provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.”*, ndërsa neni 174 përcakton se: *“ Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”*.

Duke pasur parasysh se të paditurit kanë ushtruar veprimtari të rrezikshme dhe atë pa leje përkatëse, të njëjtit kanë qenë përgjegjës edhe për kompensimin e dëmit material dhe jo material që i është shkaktuar paditësit, për arsye se po që se të paditurit do e kishin mirëmbajtur – kolovajzën në gjendje të rregullt nuk do të vinte deri te aksidenti dhe paditësi nuk do të pësonte lëndime.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Vendimi për kamatën është marrë në përputhje me nenin 277 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2835/18, me datë 04.08.2021

Kryetari i kolegjit
Faton Ademi